REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E FINANCAVE

EKONOMIA DHE BUXHETI

ECONOMY AND BUDGET

MAJ - MAY

TIRANE, 2004

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISE

Raporti Mujor

Maj 2004

Personi i kontaktit: Luiza JANO
Telefon: ++355 4 258437
E-mail: macro.director@minfin.gov.al

PERMBAJTJA

1. VECORITE KRYESORE.....4

2. TIPARE TË TABELAVE SPECIFIKE..... ...6

a. IÇK DHE TREGUES TË TJERË.....6

b. SEKTORI FISKAL.....8

c. SEKTORI MONETAR.....10

3. TABELAT MBËSHTETËSE

a. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

b. Kursi i këmbimit

c. Buxheti i konsoliduar

d. Shpenzimet institucionale

e. Shpenzimet sipas funksionit

f. Investimet

g. Të ardhurat sipas burimeve

h. Të ardhurat sipas klasifikimit ekonomik

i. Financimi i defiçitit

j. Mjete valutore neto

k. Krediti i brendshëm

l. Oferta e parasë

m. Depozitat sipas burimeve

1. VECORITE KRYESORE :

- **Indeksi i çmimeve te konsumit** ne muajin Maj 2004, arriti ne 105.14 perqind duke u ulur me 1.7 përqind, pas qendrimit ne te njejtin nivel dhe rritjes me 0.1 perqind, perkatesisht ne muajt prill dhe mars. Norma vjetore e inflacionit ne muajin maj ishte 2.6 perqind,duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise, prej 2- 4 perqind .



- **Kursi mesatar i kembimit** per muajin Maj 2004, ishte:

  - 106.21 leke per US dollar
  - 127.63 leke per Euro

Kjo reflekton nje zhvleresimin te lehte te monedhes shqiptare, Lekut , si kundrejt dollarit amerikan me 0.58 perqind, ashtu edhe kundrej Euros, me 0.36 perqind, krahasuar me muajin prill 2004.



- **Normat e interesit te depozitave** ne leke kane vazhduar trendin e tyre renes edhe gjate 3-mujorit te pare 2004, si pasoje e likuiditetit te tepert ne ekonomi. Renien me te ndjeshnme gjate kesaj periudhe e kane patur normat e interesit te depozitave 12-mujore, ne masen 23,9 perqind krahasuar me te njejtin tremujor te vitit te kaluar dhe 6,5 perqind, krahasuar me tremujorin e fundit te vitit 2003. Gjithashtu, renia ka qene e pranishme edhe per depozitat me afat tremujore, gjashtemujore dhe vjetore.



- **Te ardhurat buxhetore** te mbledhura deri ne fund te **muajit Maj** arriten ne rreth 70.95 miliarde leke ose rreth 36 perqind e programit vjetor 2004.

- **Shpenzimet buxhetore** , arriten ne rreth 76.9 miliarde leke, ose rreth 32 perqind e totalit te shpenzimeve buxhetore te planifikuara per gjithe vitin 2004.

- Si rrjedhim **deficiti i pergjithshem** ishte rreth 5.9 miliarde leke, ose rreth 14.1 perqind e deficitit buxhetor per vitin 2004.



- Megjithëse shpenzimet totale ishin rreth 32 përqind e buxhetit vjetor, **shpenzimet korrente** arriten ne rreth 68.4 miliardë lekë ose rreth 36.8 përqind e programimit vjetor.

- **Të ardhurat gjithsej** per pesemujorin përfshijnë:
  - Mbledhjet e te ardhurave tatimore nga administrata e tatimeve dhe doganave në 36.8 përqind të programimit vjetor;
  - Kontributet për sigurimet shoqërore prej 37.5 përqind ;
  - Të ardhurat jo-tatimore 30.2 përqind te buxhetit vjetor; dhe
  - Të ardhurat nga pushteti lokal 47.6 përqind te planifikimit vjetor

- **Oferta totale e parasë**, e matur nga M3 arriti në 456 miliardë lekë në fund të muajit Mars, duke shenuar një rritje me rreth 8 perqind ne krahasim me te njejten periudhe te vitit te kaluar.



- Rritja u reflektua në **depozitat** me afat ne leke me rreth 13.8 perqind, depozitave ne valute rreth 10 perqind, depozitave pa afat me rreth 5 perqind dhe renien e parase jashte sistemit me rreth 3 perqind krahasuar me nje vit me pare.



2. TIPARE TE TABELAVE SPECIFIKE:

a. Indeksi i Çmimeve te Konsumit dhe tregues të tjerë:

- Indeksi i Çmimeve te Konsumit

Indeksi i Cmimeve te Konsumit gjate muajit maj pesoi nje ulje prej -1.7 perqind, pas ndryshimit me 0.0 perqind dhe rritjes prej 0.1 perkatesisht ne muajin prill dhe mars. Ndryshimet respektive ne te njejtet muaj, nje vit me pare ishin –1.1 perqind, 0.8 perqind, dhe 0.4 perqind.

Ulja e indeksit te çmimeve te konsumit ne muajin Maj 2004 prej 1.7 perqind eshte kryesisht rezultat i uljes se indeksit te grupit "Ushqime dhe pije joalkolike", me – 4.2 perqind. Brenda ketij grupi mund te permendet ulja e cmimeve per nengrupin "zarzavate perfshi patatet" prej 21 perqind. Ulje kane pesuar edhe grupi "Shendeti", "Sherbimi arsimor dhe "Mallra dhe sherbime te ndryshme" me – 0.1 perqind.

Ne muajin maj, norma vjetore e inflacionit u ul ne 2.6 perqind, duke qendruar brenda objektivit te Bankes se Shqiperise.

Rritjet me te medha vjetore verehen ne grupet "Komunikim" prej 17.4 perqind, "Qera,uje lende djegese dhe energji" me 9.7 perqind dhe "Sherbimi arsimor" prej 9.5 per qind, ndersa uljet me te medha vjetore verehen ne grupet "Veshje dhe kepuce" prej –2.2 perqind dhe "Mallra dhe sherbime te ndryshme" prej –1.7 per qind.

Ndryshimet vjetore te indeksit te çmimeve te konsumit, ne perqindje, per vitet 2003 dhe 2004 paraqiten ne tabelen e meposhtme:

	Jan	Shku	Mars	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nen	Dhj.
2004	3.3	4.4	4.0	3.2	2.6							
2003	0.0	1.1	1.4	2.3	2.8	2.6	3.0	3.0	2.7	2.9	3.4	3.3

- Kursi mesatar i këmbimit

Gjate muajit **maj** vihet re nje zhvleresim i monedhes shqiptare kundrejt te dy monedhave me kryesore, Euros dhe dollarit amerikan perkatesisht ne masen 4.5 perqind dhe 2.3 perqind , **kundrejt fillimit te muajit**.

Kursi mesatar i kembimit per dollarin pesoi ulje ne muajin maj pas nje rritjeje ne muajin prill. Ne fund te muajit maj 2004, kursi i kembimit Lek/USD arriti vleren 104.51 krahasuar me mesataren mujore prej 106.21.

Kursi i kembimit Lek/Euro u ul ne nje vlere mesatare prej 127.63 ne muajin maj krahasuar me 128.09 ne muajin prill, ndersa ne fund te muajit maj, nje Euro shkembehej me 127.66 Leke.

Gjate muajit Maj 2004 vihet re nje zhvleresim mesatar i monedhes shqiptare kundrejt te dy monedhave si per dollarin amerikan ashtu edhe per monedhen Europiane, perkatesisht ne masen 0.58 perqind, dhe 0.36 perqind, krahasuar me nje muaj me pare.

Kursi mesatar i kembimit Lek/USD u ul nga 106.84 ne prill, ne 106.21 ne muajin maj, ndersa kursi mesatar i kembimit Lek/Euro u ul nga 128.09 ne 127.63 ne prill.



Duke u krahasuar me muajin maj te vitit te kaluar rezulton qe monedha shqiptare (Lek) eshte vleresuar ndjeshem ndaj dollarit amerikan (USD) ne masen 12.4 perqind dhe ndaj monedhes europiane (Euro) ne masen 9.1 perqind.

-Interesi i huave

Interesi i huave 12 mujore ne muajin Mars arriti ne 16,1 perqind nga 10,5 perqind qe ishte ne muajin Shkurt duke u rritur me rreth 53,3 perqind, ndersa interesi i huase 6-mujore u ul me rreth 22.9 perqind, nga 13,5 perqind qe ishte ne muajin Shkurt ne 10,4 perqind ne muajin Mars.

Interesat e Bonove të Thesarit 12 mujore rane nga 9,4 përqind në 9,2 përqind, ndersa interesat e bonove te thesarit gjashtemujore rane nga 8,5 perqind ne 8,3 perqind ne muajin Mars.



b. Sektori Fiskal

- Buxheti i Konsoliduar

Ne fund te muajit Maj jane mbledhur rreth 70.95 miliarde leke te ardhura, perkundrejt shpenzimeve te pergjithshme prej 76.9 miliarde leke, qe perfshijne rreth 68.4 miliarde leke shpenzime korente dhe 8.5 miliarde leke shpenzime kapitale. Si rrjedhim, deficiti arriti ne nivelin e 5.9 miliarde leke.

Mbledhja e te ardhurave perben 35.8% te te ardhurave buxhetore per vitin 2004, ndersa shpenzimet perbejne 329% te buxhetit te planifikuar. Shpenzimet korente jane 36.8% e planifikimit vjetor, ndersa shpenzimet kapitale jane 17.6%.

Nga te ardhurat gjithsej, te ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat jane 46.2 miliarde leke (36.8% e te ardhurave vjetore te planifikuara), te ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 5.4 miliarde leke (47.6% e te ardhurave vjetore te planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore 12.6 miliarde leke (37.5% e te ardhurave vjetore te planifikuara), dhe te ardhurat jo-tatimore ne nivelin e 6.3 miliarde leke (30.2% e te ardhurave vjetore te planifikuara).

Nga totali i shpenzimeve korente prej 68.4 miliarde leke, 18.3 miliarde leke (26.7%) jane shpenzuar per personelin, 13.0 miliarde leke (19.1%) per interesat, 8.1 miliarde leke (11.9%) per shpenzime operative dhe te mirembajtjes, 1.6 miliarde leke (2.4%) per subvencione, 19.2 miliarde leke (28.0%) per shpenzimet e sigurimeve shoqerore dhe 8.2 miliarde leke (11.9%) per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera.

Keto perfaqesojne 35.8% (personeli), 41.9% (interesat), 36.4% (shpenzime operative dhe mirembajtje), 39.1% (subvencione), 38.7% (sigurimet shoqerore), 26.4% dhe 35% (per shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) perkundrejt buxhetit te planifikuar vjetor.

Shpenzimet kapitale arriten ne rreth 8.5 miliarde leke nga te cilat 52.5 % financim i brendshem, dhe 47.5% financim i huaj.
Financimi i brendshem i shpenzimeve kapitale llogaritet per kete periudhe ne rreth 17.9% te buxhetit te parashikuar vjetor, ndersa financimi i huaj eshte ne rreth 17.2%.

Deficiti prej 5.9 miliarde lek eshte i barabarte me 14.1% te deficitit buxhetor per 2004.

-Të ardhurat sipas Burimeve / Klasifikimit Ekonomik

Te ardhurat gjithsej në fund të Maj 2004 arriten ne rreth 70.9 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore ne rreth 64.3 miliardë, grantet 0.4 miliarde dhe të ardhurat jo-tatimore ne rreth 6.3 miliardë;

Nga totali i të ardhurave tatimore, 46.2 miliardë lekë janë mbledhur nga administrata e doganave dhe e tatimeve, 5.4 miliardë lekë të ardhura nga pushteti lokal dhe 12.6 miliarde leke nga kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore;

Nga të ardhurat totale të mbledhura deri në fund të Majit:

- TVSH përbënte 21.6 miliardë lekë
- Tatimi mbi fitimin 6.1 miliardë lekë
- Taksa doganore 5.1 miliardë lekë
- Taksat nacionale dhe te tjera 4.4 miliardë lekë
- Akcizat 5.5 miliardë lekë
- Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë 2.1 miliardë lekë;

-Financimi i Defiçitit

Defiçiti prej 5.9 miliardë lekë, ne fund te Majit 2004, ishte 53.6 përqind me financim të brendshëm dhe 46.4 përqind me financim të huaj. Nxjerrja e bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndersa për financimin e huaj, huatë afatgjata.

c. Sektori Monetar

-Mjetet Valutore Neto te sistemit bankar

Gjate tremujorit te pare 2004, sistemi bankar ka shenuar rritje te mjeteve valutore neto, me rreth 34,6 milione dollare.
Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se mjeteve valutore neto te bankave te nivelit te dyte me rreth 37,8 milione usd, nderkohe qe mjetet valutore neto te B.Sh. te shprehura ne dollare kane pesuar renie ne masen 3,2 milione dollare. Renia e M.V.N te B.SH reflekton nencmimin e euro-s kundrejt dollarit me rreth 3 perqind gjate kesaj periudhe.



-Kredia per ekonomine

Teprica e kredise per ekonomine gjate tremujorit te pare 2004 eshte rritur me rreth 2,4 miliarde leke, rritje rreth 41,1 perqind me e larte krahasuar me te njejten periudhe te vitit te kaluar.

Tendenca pozitive e kreditimit te ekonomise vihet re ne treguesin e kredise se re te akorduar per ekonomine, por mbetet ende problematike struktura e kredise, ku pjesen me te madhe e zene kredite afatshkurtra, ne masen 67 perqind te totalit te kredise se re te akorduar.

Ne fund te muajit Mars, raporti i kredise per ekonomine ndaj kreditit te brendshem arriti ne 16,3 perqind nga 15,8 perqind qe ishte tre muaj me pare.

Ne terma relative, ecuria e kredise per ekonomine ka manifestuar nje rritje me te larte se ajo e kredise per qeverine, gje e cila ka cuar ne rritjen e peshes se saj ne totalin e kreditit te brendshem.
Kredia e brendshme eshte rritur me 5,9 miliarde leke gjate tremujorit te pare te vitit 2004.

Rritja e kerkeses se Qeverise per mjete monetare ka perfaqesuar rreth 54 perqind te rritjes se kredise se brendshme gjate periudhes ne fjale, ndersa pjesa tjeter ka ardhur si rezultat i rritjes se kreditimit te ekonomise.



-Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), kapi shifren rreth 456 miliardë lekë në fund të muajit Mars duke shenuar nje rritje 0,92 perqind krahasuar me nje muaj me pare, ndersa rritja vjetore e ketij treguesi ishte 8 per qind.

Tendenca renese e raportit te parase jashte bankave ndaj ofertes monetare ka vazhduar me te njejtin ritem te muajve te meparshem. Ky raport, ne muajin Mars arriti ne 25,7 perqind, qe eshte edhe vlera me e ulet e rregjistruar ne 5 vitet e fundit.



Depozitat ne leke kane qene perberesi i ofertes monetare me rritjen vjetore me te larte. Megjithate, norma vjetore e rritjes se tyre ka pesuar renie gjate tremujorit te pare 2004, duke zbritur nga 15,7 perqind ne 14.0 perqind.

Ecuria e depozitave ne valute eshte ndikuar ne nje mase te madhe nga zhvillimet ne kursin e kembimit, dhe si rezultat i mbicmimit te lekut kundrejt valutave euro dhe usd, niveli i tyre paraqitet rreth 13,2 miliarde leke me i ulet. Ne muajin Mars norma vjetore e depozitave ne valute arriti ne 11,3 perqind.
Ne mungese te efektit te kursit te kembimit rritja e tyre ishte 25,5 perqind.

-Depozitat sipas Burimeve

Gjate tremujorit te pare 2004:

➢Sektori privat ishte burim i rëndësishëm i depozitave pa afat ne leke (rreth 39,2 perqind) ndjekur nga ndërmarrjet publike jo-financiare (rreth 37 perqind)

➢Sektori privat si edhe individidet ishin gjithashtu burimi me i rëndësishëm i depozitave pa afat në monedhe të huaj, me rreth 41,7 perqind sektori privat dhe individet me rreth 41 perqind, me nje diference midis tyre per muajin Mars vetem 0,7 perqind.

➢Familjarët ishin dukshëm burimi me i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96,4 përqind te totalit) dhe depozitave me afat në monedhe të huaj (me 91,6 përqind te totalit te depozitave;

➢Në përgjithësi, familjarët përbënë pjesën më të madhe (rreth 83,3 përqind) të depozitave totale prej 339 miliardë lekë ne muajin Mars 2004. Ata ndiqen nga sektori privat (9,56 përqind), ndërrmarjet publike jo-financiare (6 për qind) dhe autoritetet lokale (1 përqind). Institucionet financiare kontribuan me 0.07 për qind ne totalin e depozitave.

➢Gjatë muajit Mars niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 6,7 miliardë lekë, si rezultat i rritjes se depozitave me afat në lekë (0,9 miliardë lekë) rritja e depozitave pa afat ne monedhe te huaj (2,1 miliarde leke) rritja e depozitave pa afat ne leke (3,2 miliarde leke) dhe rritja e depozitave me afat ne valute (0,5 miliarde leke).

➢Depozitat me afat ne leke të sektorit privat pesuan nje renie prej 0,08 miliarde leke, ndersa depozitat me afat ne valute te familjareve gjate muajit Mars u rritem me rreth 0.5 miliarde leke

Ne menyre grafike, kontributi i sektoreve ndaj totalit te depozitave paraqitet: